



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Vushtrri në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2012

Neni 1

Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012, në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2012 të MEF-it, dhe kërkesave të programeve buxhetore të komunës.

Neni 2

Mjetet e rishikuara barten sipas tabelës standarde, që është në shtojcë të këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012**, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Është në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.06.2012 dhe zgjat deri më 20.06.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Propozim-vendimit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012**, pas shqyrtimit të Draft-rregullores për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Është në diskutim publik Draft-rregullorja për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.06.2012 dhe zgjat deri më 20.06.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.4 dhe 41.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 43.3 të Rregullave financiare dhe shpenzimet e thesarit nr.02 – shpenzimi i parasë publike, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012** mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01 Nr.37-2/11, dt. 24.02.2011 për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike.

Neni 2

Në paragrafin 1.2 të nenit 1, para fjalëve “Kryetari i Komunës” shtohen fjalët “Kuvendi i Komunës”, kurse fjala “ndanë” zëvendësohet me fjalën “ndajnë”.

Neni 3

3.1 Pas paragrafit 8.1 të rregullores në fjalë shtohet paragraf i ri me këtë tekst: “Në raste emergjente (fatkeqësive natyrore etj), Kryetari i komunës mund të ndajë ndihma momentale financiare në vlerë më të madhe se 500.00 €, dhe për këtë do ta njofton kuvendin e komunës në mbledhjen e radhës”.

3.2 Paragrafi 8.2 i rregullores në fjalë riformulohet siç vijon: “Për çdo shumë më të lartë se ajo e përcaktuar në paragrafin 8.1 vendos kuvendi i komunës”.

Neni 4

Pikës 2 të paragrafit 11.1 i shtohen fjalët: “nga komisioni kompetent i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale”.

Neni 5

Neni 12 i rregullores në fjalë riformulohet siç vijon: “Përfitues i ndihmës momentale mund të jenë vetëm entitetet publike dhe jopublike të Komunës së Vushtrrisë”.

Neni 6

Në fund të nenit 14 të rregullores në fjalë shtohen fjalët: “por jo më tepër se dy vite radhazi”.

Neni 7

Pas nenit 16, shtohet neni i ri (17), me dy paragrafe, me këtë përmbajtje:

“17.1 Pas marrjes së vendimit për ndarje të ndihmës momentale për entitete publike përfaqësuesi ligjor i përfituesit (entitetin publik) dhe të lidh marrëveshje me zyrtarin kompetent të komunës për shfrytëzimin e atyre mjeteve”.

“17.2 Pas marrjes së vendimit për ndarje të ndihmës momentale për entitetet jopublike, përfaqësuesi ligjor i përfituesit (entiteti jopublik) do të lidh marrëveshje me zyrtarin kompetent të komunës për shfrytëzimin e atyre mjeteve, nëse ndihma momentale kalon shumën prej 300 €”.

Neni 8

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoritë komunale të ngarkuara gjatë vitit fiskal me mjetet buxhetore të transfereve dhe subvencioneve.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 11 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 44.1 të Ligjit mbi tokën bujqësore nr.02/L-26, nenin 17.3 "a" të Ligjit mbi planifikimin hapësinor nr.2003/140, nenin 6.2 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore nr.41/2006, nenin 40 "k" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012** mori këtë:

V E N D I M

Mbi lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Neni 1

Me këtë vendim lejohe ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, e cila është e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70202010-00217, parcela kadastrale: nr.57/4, vendi i quajtur "pruga" me kulturë arë e klasit të tretë, në sipërfaqe prej 0.24.60 ha, ZK Bukosh, Komuna Vushtri, pronë e Islam Hysenit nga fshati Bukosh.

Neni 2

Në parcelën kadastrale të cekur si në nenin 1 të këtij vendimi lejohe ndërtimi i objektit për banim familjar.

Neni 3

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore do ta lëshojë lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga neni 2 i këtij vendimi dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore.

Neni 4

Obligohet pronari i parcelës nga neni 1 i këtij vendimi, që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 "a" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe të nenit 54.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit të KPF-së

Neni 1

Me këtë vendim emërohet Shpëtim Zhegrova (PDK) anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) i KK-së në Vushtri.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 11 dhe 12 "d" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe kërkesës së tri shoqatave të dalura nga lufta të datës 28.03.2012, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës që të angazhohet për shqyrtuar kërkesën e tri shoqatave të dalura nga lufta për t'u ndarë mjete shtesë financiare për vitin 2012, për mbulimin e nevojave të tyre.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41.1 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në propozimin e grupit kuvendar të AAK-së të datës 31.05.2012, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012**, miraton këtë:

D E K L A R A T Ë

Duke u bazuar në gjendjen e rëndë sociale të pensionistëve në Kosovë, të cilët kanë mbetur pa përkrahje materiale dhe shëndetësore, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë përkrah kërkesat e tyre të drejta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së tyre.

Njëherit Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga organet kompetente të shtetit të Kosovës që ato kërkesa të arsyeshme t'i miratojnë në mënyrë që të zgjidhet statusi i tyre sa më parë.

Prandaj, është obligim dhe përgjegjësi që kjo kategori e popullatës të ketë një jetë të dinjitetshme.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "h" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 40 "gj" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për ndarje të plaketave dhe mirënjohjeve për nder të Ditës së Çlirimit

Neni 1

Me këtë vendim për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2012, nderohen me plaketa dhe mirënjohje siç vijon:

PLAKETA:

- 1. Enver Zymberi** – (Post mortum) për kontributin e dhënë në mbrojtjen e integritetit shtetëror të Republikës së Kosovës.
- 2. Brahim Gjaka** - (veteran i UÇK-së) për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë.
- 3. Habib Kamberi** (veteran i UÇK-së) për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë.
- 4. Sami Krasniqi** - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.
- 5. Sadik Idrizi** - (Post mortum) invalid, i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.
- 6. Beshir Krasiniqi** - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.
- 7. Lutfi Islami** - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.
- 8. Sefedin Morina** - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.
- 9. Vesel Shyti** - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.
- 10. Sabri Maxhuni Novosella** – për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.
- 11. Bali (Ibish) Dervishi** – (ish i burgosur politik) për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.
- 12. Islam (Hasan) Mulaku**- për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.

13. **Dr. Shaban Merovci** – (Post mortum) për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë.
14. **Dr. Agim Drevinja** – (Post mortum) për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë.
15. **Dr. Safet Rexha** – për kontributin e dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovë.
16. **Shemsi Rrahimi** – kryetar i BI-së në Vushtrri, për kontributin e dhënë në çështjen fetare dhe kombëtare.
17. **Abdyll Uka** – për akt trimërie në mbrojtjen e nderit të familjes.
18. **Dr. Mejreme Ismajli** – për kontributin e dhënë ndaj të plagosurve gjatë luftës në Kosovë.
19. **SHMU “Bahri Kuqi”** – për rezultate të larta në procesin mësimor dhe edukativ në nivelin regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar.
20. **Kudusi Lama** - për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.
21. **Aziz Zhilivoda** - për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.

MIRËNJOHJE:

1. **Remzi Prronaj** – për kontribut të dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovës.
2. **Behram Rrahmani** – për kontribut të dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovë.
3. **Shukri Ademi** – për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë.
4. **Sanie Bajrami-Qosi** – (ish-arsimtare) e burgosur, e cila dha kontribut në mbrojtjen e shkollës shqipe.
5. **Akile Dedinca-Zhegrova** – për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.
6. **Dinore Sheremet- Curri** – për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.
7. **Fazli Isa Ademi** – (post mortum) ish i burgosur politik
8. **Ajet Ferat Berisha** – për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.
9. **Mexhide Shoholli** – për kontributin e dhënë në lëmin e infermierisë.
10. **Dr. Safet Idrizi** – për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësisë.
11. **KH “Samadrexha” (M)** – për suksese të larta në garat në nivel vendi.
11. **KF “Kosova”**- për rezultatet e arritura në futboll.
12. **Klubi i Volejbollit “Gjimnazisti”** – për arritje të rezultateve të larta në nivel komunal, regjional dhe në nivel të Kosovës.
13. **OJQ Rinore “Lëvizja Koha”**- për aktivitete të suksesshme me të rinjtë e Komunës së Vushtrrisë.
14. **Fazli Muharremi** – për kontributin e dhënë si aktor dhe regjisor në teatrin në Vushtrri.
15. **Musa Fejzullahu** – për kontributin e dhënë në lëmin e muzikës dhe aktrimit në Vushtrri.
16. **Isuf Zhegrova** – për të arriturat në lëmin e biznesit.
17. **Kotex-i** – për kontributin e dhënë në prodhimet e konfeksionit të lehtë.
18. **Molitoria** nga Bukoshi – për kontributin e dhënë në grumbullimin dhe përpunimin e drithërave.
19. **Emona Center-** Vushtrri- për biznes të suksesshëm brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
20. **Driton Morina** nga Akrashtica- për prodhimtari të lartë në bujqësi.

21. **Sabedin Hajredinaj** nga Stanocii Epërm- fermer i dalluar në blegtori.
22. **Sedat Kasumi** nga Pestova – për arritjen e rendimenteve të larta në kultivimin e patates.
23. **Vjendita Pllana**- në SHMU “Bahri Kuqi”, për sukseset e arritura në garat kombëtare të organizuara nga Instituti i Gjuhës “Gjuhëtari i Ri”.
24. **Merita Ademi** – arsimtare e dalluar e matematikës në SHMU “Bahri Kuqi” Shtruhërë.
25. **Vjollca Pllana** – arsimtare e dalluar e gjuhës dhe letërsisë shqipe në SHMU “Bahri Kuqi” Shtruhërë.
26. **Muhamet Xhemajli** (post mortum)- ish-drejtor në SHMU “28 Nëntori” në Vërnice, për kontributin e dhënë në themelimin e kësaj shkolle.
27. **Afërdita Dervishi** – inxh. e diplomuar, e persekutuar, e përndjekur dhe e dënuar padrejtësisht nga regjimi i asaj kohe.
28. **Ferki Kadriu** nga Novolani – bujk i suksesshëm.
29. **KV nga Shtruhëra** – për sukseset e arritura në volejball.
30. **SHM Gjinnazi “Eqrem Qabej”** – për rezultatet e arritura në nivel të Republikës së Kosovës.
31. **Mexhit Merovci** – mërgimtar, për kontributin e dhënë për ndërtimin e shtëpive për familjet e pastrehë.
32. **Kryqi i Kuq (Vushtrri)**- për kontributin e dhënë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.
33. **Mexhit Përçuku** – për rezultate në punë në lëmin e financave.
34. **Mursel Bllata** – (post mortum) për akt trimërie në mbrojtjen e nderit të familjes.
35. **Arbnor Gashi** – (nxënës) për rezultatet e arritura në lëmin e matematikës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa